

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

AGJENCIA RAJONALE E EKSTENSIONIT BUJQËSOR TIRANË

RAPORT MONITORIMI
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT
TË AGJENCISË RAJONALE TË
EKSTENSIONIT BUJQËSOR

2025

**RAPORT MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT GJATË VITIT NË
AREB TIRANË VITI 2025**


Periudha e raportimit : Janar–Dhjetor 2025

Pregatiti : Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Tiranë .

Autorët : Grupi Punës

Emër Mbiemër

Adriatik Beluli



Pozicioni

**Kordinator i Integritetit, Specialist Sek Specialisteve te
Profilizuar.**

Zyhdi Cllhaj



**Kordinator i Informimit, Pergjegjes i Sektorit te Specialisteve
te Profilizuar.**

Marsilda Dervishi



Pergjegjese e Sektorit te Finances dhe Sherbimeve.

Gerantina Llanaj



Pergjegjese e SEB Tiranë

Roland Doda



Pergjegjes i komanduar i SEB Dibër

Mezejen Hysa



Pergjegjese e SEB Durrës

Ornela Dedej



Specialiste Burime Njerzore/Arkivë/Magazinë

Miratoj: Drejtori AREB Tiranë me Urdhër Nr. 65/2 datë 18 . 3 2026

ALFRED CENGU



Lista e shkurtesave

MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
AREB	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor
MVRI	Metodologjia e Vlerësimit dhe Riskut
PSV	Procedura Standarte Veprimi
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

TABELA E PËRMBAJTJES:

Përmbajtja :

- 1.Hyrje:
- 2.Kuadri ligjor :
- 3.Përmbledhje Ekzekutive:
4. Qasja vlerësuese:
5. Metodologjia e vlerësimit:
6. Gjetjet e Raportit :
- 7.Progresi në Zbatimin e Planit të Monitorimit:
 - 7.1 Rritja e Efektivitetit në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore:
 - 7.2. Sigurimi i Informacionit Bashkëkohor për Bujqësinë:
 - 7.3.Masat për Menaxhimin e risqeve :
 - 7.4. Menaxhimi Financiar:
 - 7.5 Masat për Menaxhimin e Risqeve të Integritetit:
 - 7.6 Masat për Menaxhimin e Risqeve të Integritetit:
 - 7.7 Monitorimi i Planit të Integritetit:
- 8.Konkluzione dhe Rekomandime :
- 9.Hapa të tjerë :
10. Përfundim

1. Hyrje:

Ky raport monitorimi synon të vlerësojë nivelin e zbatimit të Planit të Integritetit të Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë (AREB Tiranë) për vitin 2025.

Raporti është hartuar në përputhje me objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe ka për qëllim rritjen e integritetit institucional dhe transparencës në ofrimin e shërbimeve publike në dobi të fermerëve. Qëllimi është vlerësimi i zbatimit të Planit të Integritetit, parandalimi i korrupsionit, forcimi i transparencës dhe rritja e llogaridhënjes në administrimin e fondeve publike.

2. Kuadri ligjor :

Monitorimi është bazuar në :

- Legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit.
- Legjislacioni për Menaxhimin Financiar dhe Prokurimin Publik.
- Rregulloren e brendshme të AREB Tiranë dhe urdhërat e Titullarit AREB Tiranë.
- Planin e Integritetit 2025-2027.

3. Përmbledhje Ekzekutive :

Ndërtimi i integritetit është një aspekt i rëndësishëm për funksionimin e demokracisë dhe një domosdoshmëri për shtetin e së drejtës. Korrupsioni është një fenomen që ndikon shumë në besimin e publikut në rastin e AREB Tiranë edhe fermerët, duke dëmтуar rëndë efektivitetin e institucioneve dhe njëkohësisht çënon legjitimitetin demokratik të tyre. Qeveria shqiptare ka shpallur si prioritet kryesor luftën kundër këtij fenomeni.

Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative.

Angazhimin në forcimin e kuadrit institucional, strategjik, ligjor dhe operacional në fushën antikorruption ka çuar MBZHR dhe institucionet e saj drejt hartimit, miratimit dhe aplikimit të instrumenteve konkrete kundër korrupsionit me qasje parandaluese dhe ndëshkuese.

Po kështu edhe AREB Tiranë në këtë kontekst hartoi dhe miratoi instrumentin me karakter parandalues në luftën kundër korrupsionit: Planin e Integritetit dhe Planin e Veprimit 2025-2027 të institucionit, të miratuar nga titullarit AREB Tiranë me nr 151/3, datë 29.05.2025.

Plani i Integritetit është hartuar duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlersimit të Riskut të Integritetit. Mbi këtë bazë të gjithë strukturat e organigramës të përcaktuar në grupin e punës përcaktuan planin e aktiviteteve duke bërë pjesë pjesë e programeve të punës së tyre në funksion të realizimit të objektivave kryesore si më poshtë vijon :

Objektivi 1: Formcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit.

Objektivi 2: Administratimi Financiar për përdorimin me efikasësi, kursimin e dobishëm të burimeve financiare dhe rezervave ekonomike për të realizuar politikat e programit të AREB Tiranë të shprehura në buxhetin e përcaktuar.

Objektivi 3: Forcimi i Integritetit në sistemin e prokurimeve.

Objektivi 4: Përmisimi i proceseve të Integritetit, transparencës dhe llogaridhënjes me fermerët dhe publikun.

Objektivi 5: Forcimi i një sistemi funksional të integritetit përmes fuqizimit të një administrate profesionale dhe efikase. Realizimi i planit të trajnimeve për punonjësit egzistues dhe të rinj si dhe ndjekja e procedurave për plotësim vakante.

Objektivi 6: Organizimi dhe Monitorimi i procesit të shërbimit të Ekstensionit Bujqësor në përputhje me udhëzimet e BE.

Objektivi 7: Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullator, monitorim dhe kontroll i programit të shërbimit të Ekstensionit nga Sektori i Profilizuar.

Objektivi 8 : Promovimi i Marketingut të produkteve bujqësore e blegtorale si dhe krijimi i grupeve të fermerëve SHBB .

Objektivi 9 : Mbledhja , përpunimi , zhvillimi i statistikave në funksion të Realizimit të Rregjistrimit të Fermës Portalit të Fermerit , Vjetarit Statistikor , VVB, VSM, Evidenca koherente duke respektuar parimet themelore të statistikave në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane dhe Ligjit Evropian për Statistikat si dhe Programit Kombëtar për Statistikat Zyrtare .

Gjithashtu, gjatë hartimit të Planit të Integritetit 2025-2027, AREB Tiranë , ngriti grupin e punës me Nr 65/1 datë 10.02.2026 për vlerësimin e riskut të integritetit dhe përgatitjen e planit të integritetit të AREB Tiranë , ku në përbërje të grupit të punës ishin punonjës të nivelit drejtues, për të siguruar mbarëvajtjen e proceseve dhe koordinimin e aktivitetetve në institucion.

Planin e Integritetit të AREB Tiranë paraqet një instrument i luftës kundër korrupsionit, për të patur një administratë publike profesionale, me etikë, integritet dhe e angazhuar për t'iu shërbyer qytetarëve në fushën e bujqësisë, blegtorisë, etj. Ky plan ka të parashikuar masa të identifikuar në fushatë përgjegjësisë institucionale të AREB-it dhe konkretisht në drejtim të ekstensionit, financës, prokurimeve, burimeve njerëzore, sektorit të profilizuar etj. Në Planin e Integritetit përmban masa të karakterit rregullator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë ato të përcaktuara në urdhërin e titullarit grupi i punës që hartoj dhe PI.

Në përputhje me detyrat e përcaktuara grupi i punës mbledhi materialet e nevojshme për hartimin e Raportit të Monitorimit të Zbatimit të PI për AREB Tiranë për vitin 2025.

Raporti Vjetor paraqet të dhënat lidhur me realizimin e objektivave , masave dhe aktiviteteve të realizuara sipas fushave përkatëse. Për vitin 2025 ishin parashikuar për zbatim objektiva 20 dhe në funksion të tyre aktivitete sipas sektorve përkatës dhe çdo objektive për të realizuar në funksion të vizionit të AREB Tiranë.

Nga monitorim rezultoi se nga 20 objektiva strategjike të parashikuara për zbatim janë realizuar të gjitha.

4.Qasja Vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë, përmban një analizë të përgjithshme të performancës institucionale, kuadrit rregullator mbi aspekte të integritetit në AREB për ti rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështje të transparencës institucionale në luftën kundër korrupsionit.

5.Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të 5 sektorve të AREB Tiranë , grupit të punës me urdhër të brendshëm nr.65/1 datë 10.02.2026 si dhe koordinitorit të integritetit .Raporti përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasiore e kontributit të tyre. Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlersimin institucional të kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre . Analiza sasiore e këtij raporti vjetor bazohet në vlersimin e të dhënave statistikore të strukturave dhe njësive kontribuse, si dhe anketave të kryera .

5.1Metodologjia e monitorimit

Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit është kryer nëpërmjet:

- Vlerësimit të dokumentacionit dhe praktikave institucionale.
- Intervistave me stafin e institucionit.
- Analizës së riskut dhe masave të zbatuara.
- Raportimit të rregullt nga strukturat përgjegjëse për implementimin e masave.

Grupi i Punës për Hartimin e Planit të Integritetit:

Emër Mbiemër	Pozicioni
Adriatik Beluli	Kordinator i Integritetit
Zyhdi Cilhaj	Kordinator i Informimit,Përgjegjës i Sektorit te Specialisteve te Profilizuar.
Marsilda Dervishi	Përgjegjese e Sektorit te Finances dhe Shërbimeve.
Gerantina Llanaj	Përgjegjëse e SEB Tiranë
Mezejen Hysa	Përgjegjëse e SEB Durrës
Roland Doda	Përgjegjës e SEB Dibër
Ornela Dedej	Specialiste Burime Njerëzore/Arkivë/Magazinë

5.2 Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga grupi punës dhe Koordinatori Integritetit nga Analiza Vjetore e Performancës së AREB Tiranë 2025 në funksion të përmbushjes së rolit të tij për ti raportuar titullarit , i idhur me zbatimin e planit të të integritetit. Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuse në këtë raport nga strukturat e organigramës së AREB Tiranë. Mbledhja e informacionit nga këto njësi është realizuar nëpërmjet raportimit të hapave të ndërmara dhe statusin për realizimin e tyre , akte dhe dokumenta të hartuara .

6.GJETJET E RAPORTIT

Objektivi 1:

Formcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit.

Përmes këtij objektivi AREB Tiranë ka synuar forcimin e mekanizmave të brendshëm rregullator dhe kontrollit në funksion të zbatimit të Ligjit Nr.10296 dt 08.07.2020 “ Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ” për të garantuar zbatimin e ligjshmërisë dhe ruajtjen e akteve të AREB Tiranë.Po kështu nga titullari AREB Tiranë në kë drejtim gjatë vitit 2025 janë nxjerë edhe 2 urdhëra të brendshëm konkretisht Nr. 28 datë 18.02.2025 dhe Nr .305 datë 15.09.2025.

Objektivi 2:

Administratimi Financiar për përdorimin me efikasitet, kursimin e dobishëm të burimeve financiare dhe rezervave ekonomike për të realizuar politikat e programit të AREB Tiranë të shprehura në buxhetin e përcaktuar.

Gjatë vitit 2025 konstatohet se është punuar me përgjegjësi me synimin për të realizuar një përdorim efikas të fondeve dhe bazës materiale, në funksion të buxhetit AREB Tiranë .

Objektivi 3:

Forcimi i Integritetit në sistemin e prokurimeve.

Nga Sektori i Financës është realizuar në kohë rregjisri i parashikimit të Prokurimeve publike për 16 prokurime, për nevojat e institucionit dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi/udhëzime përkatëse dhe Agjencisë së Prokurim Publik. Specifikimet teknike kanë qënë normale për hapsirë konkurimi dhe jo te ngushta dhe kjo shikohet edhe nga numri i lartë i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në procedura te shpallura.

Ankimime nuk ka patur në procedurat e prokurimit publik .

Objektivi 1,2,3	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe Aktivitete të përealizuara
Sipas përshkrimit më lart	Masa Aktivitete	12	11	1	0

Objektivi 4:

Përmisimi i proceseve të Integritetit, transparencës dhe llogaridhënjes me fermerët dhe publikun.

Zbatimi i këtij objektivi ka synuar forcimin e integritetit të punonjësve të AREB-it Tiranë në funksion të transparencës dhe llogaridhënjes me fermerët dhe publikun, në veçanti fermerëve .

Informimi ,konsulenca e ndaj tyre për këshillim dhe të aplikuar në masat mbështetëse për to nga Skemat Kombëtare .Në vartësi të problematikave nga koordinatori i informimit janë dhëna shpjegimet e nevojshme.

Po kështu punonjësit e rinj kanë plotësuar anketën për integritetit dhe të gjithë punonjësit janë informuar ,lidhur me rregulloren për konfliktin e interesit. Nga koordinatori informimit AREB Tiranë, raportohet se gjate vitit 2025 nuk ka patur kërkesa për informim reth problematikave te cilat jane objekt i aktivitetit te institucionit tonë.

Objektivi 4	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe Aktivitete të përealizuara
Sipas përshkrimit më lartë	Masa/ Aktivitete	4	3	1	0

Objektivi 5:

Forcimi i një sistemi funksional të integritetit përmes fuqizimit të një administrate profesionale dhe efikase.Realizimi i planit të trajnimeve për punonjësit egzistues dhe të rinj si dhe ndjekja e procedurave për plotësim vakante.

Ky objektiv përmban një numër prej 3 masash dhe 6 aktivitete të planifikuara në funksion të përmbushjes së objektivit .

Janë realizuar plotësisht 2 masa dhe 1 në proces e mbartur në vitin 2026. Nga 44 trajnime të planifikuara në funksion të forcimit të kapaciteteve profesionale, janë realizuar 60 në nivel AREB-i ose 136 %.

Në përputje me legjislacionin janë bërë azhurnimet me udhëzime të ndryshme ligjore e në funksion të aktivitetit të arkivës, protokollit dhe burimeve njerëzore.

Objektivi 5	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete të realizuar plotësisht	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe Aktivitete të përfunduara
Sipas përshkrimit më lartë	Masa/ Aktivitete	3	2	1	0

Objektivi 6:

Organizimi dhe monitorimi i procesit të shërbimit të Ekstensionit Bujqësor në përputhje me udhëzimet e BE.

Në funksion të këtij objektivi të rëndësishëm, në të 3 SEB-et është realizuar promovimi i qendrave të informacionit bujqësor me synim ofrimin e informacioneve të nevojshme fermerëve si dhe ofrimin e asistencës nga ekstensionistët , lidhur me Skemat Mbështetëse Kombëtare .

Nëpërmjet fushatave sensibilizuese rajonale janë shpërndarë materiale informuese jo vetëm për skemat por edhe për implementimin e teknologjive të reja , plan biznese, krijimin e SHBB-ve, FADN, grumbullim të dhënave cilësore dhe sasiore etj. Këto aktivitete janë monitoruar nga specialistët e profilizuar. Nga 402 aktivitete të planifikuara janë realizuar 526 aktivitete ose 130 %.

Objektivi 6	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe Aktivitete të përfunduara
Sipas përshkrimit më lartë	Masa/ Aktivitete	6	6	0	0

Objektivi 7:

Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullator , monitorim dhe kontroll i programit të shërbimit të Ekstensionit nga Sektori Profilizuar.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar në mënyrë periodike kontroll i brendshëm në përputhje të plotë me statusin organizativ, qëllimit për aktivitetin e njësive të specialistëve të profilizuar në referencë të urdherit të brendshëm Nr. 28 datë 18.2.2025 dhe Nr.305 datë 15.9.2025, Rregulloren e Brendshme dhe programet e punës. Në bashkëpunim me QTTB dhe nga vetë specialistët e profilizuar janë realizuar trajnime për fermerët dhe ekstensionistët. Konkretisht nga 24 trajnime të hapura me ekstensionist të planifikuara janë realizuar 36 trajnime ose 150 %. Po kështu nga 399 ditë trajnimi për fermë janë realizuar 572 ose 143 %. Gjithashtu nga ana e specialistëve të profilizuar është synuar të realizohet implementimi i strategjisë së MBZHR në kuadër të rekomandimeve të BE për shërbimin e ekstensionit bujqësor në AREB me synim forcimin e zhvillimit bujqësor e blegtoral.

Objektivi 7	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të përealizuara
Sipas përshkrimit më lartë	Masa/ Aktivitete	6	6	0	0

Objektivi 8 :

Promovimi i Marketingut të produkteve bujqësore e blegtorale si dhe krijimi i grupeve të fermerëve SHBB.

Për gjatë vitit 2025 është punuar në drejtim të njohjes nga ekstensionistët me strukturat varjetore, sipas kultivarëve si dhe promovimi i marketingut të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Fermerët janë asistuar me informacionet e nevojshme në funksion të krijimit të SHBB-ve dhe mbajtjes së buxhetit në fermë. Janë parashikuar 3 masa për të cilat janë kryer aktivitetet e nevojshme.

Objektivi 8	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të përealizuara
Sipas përshkrimit më lartë	Masa/ Aktivitete	3	3	0	0

Objektivi 9 :


Mbledhja , përpunimi , zhvillimi i statistikave në funksion të Realizimit të Rregjistrit të Fermës ,Vjetarit Statistikor, VVB, VSM, Evidenca koherente duke respektuar parimet themelore të statistikave në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane dhe Ligjit Evropian për Statistikat si dhe Programit Kombëtar për Statistikat Zyrtare

Gjatë vitit 2025 në përputhje me objektivat e statistikës, specialistë kanë punuar në funksion të zbatimit të kalendarit vjetor, lidhur me raportimet statistikore të evidencave koherente EOM mujore, si dhe për grumbullimin dhe përpunimin e të dhëna për dokumente të rëndësishme administrative si , parashikimi I dhe II i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, Listimi Serave, Mbjellja e Dru-Frutorve të rinj, si dhe Vjetari Statistikor. Etj.Po kështu është realizuar në mënyrë koherente monitorimi i çmimeve të tregjeve të shumicës, hedhja në sistem dhe autorizimi në Portalin e Fermerit .Mbledhja e të dhënave për Regjistrin e Fermës si dhe realizimi kalendarit të Vrojttimeve Bujqësore VVB dhe VSM si dhe Anketa e Agroindustrisë

Nga 1720 VVB Dhjetor 2025 janë realizuar 100% .Pyetësor VSM nga 1371 janë realizuar 100% dhe Anketa të Agroindustrisë nga 309 janë realizuar 100%. Ecuria e Rregjistrit të Fermës gjatë vitit 2025 ka pasur problematika për shkak se sistemi është në proces azhornimi nga AZHBR është realizuar në vartesi të udhëzimeve të MBZHR.

Objektivi 9	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe Aktivitete të përfunduar
Sipas përshkrimit më lartë	Masa/ Aktivitete	8	7	1	0

Statusi i zbatimit të Planit të Integritetit AREB Tiranë



7. Progresi në Zbatimin e Planit të Integritetit

Objektivat Strategjikë 2025-2027

Nr.	Objektivi strategjik
1.	Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore.
2.	Përmisimi i sistemit të planifikimit, sigurimi i burimeve financiare dhe administrimit të buxhetit.
3.	Sigurimi i informacionit bashkohor për fushën e bujqësisë në kuadër të integritetit në BE.

7.1 Rritja e Efektivitetit në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

- Gjendja aktuale: Struktura e institucionit ka 63 punonjës , nëpunës të shërbimit civil dhe 1 me kodë pune. Nga keto 6 pozicione janë ende vakante.
- Përmirësime: Procesi i rekrutimit është përmirësuar, por mungesa e një juristi, specialisti IT dhe magazinjere në organigrame mbetet problematike.
- Po kështu në kuadër të integritetit në BE, në përmbushje të detyrimeve përkatëse ngarkesa e specialistëve të statistikes , krahas rritjes së kërkesave në vijim nga MBZHR e bën të domosdoshme shtimin e stafit dhe krijimin e Sektorit të Statistikes dhe FADN
- Sfida: Nevoja për plotësimin e vendeve të lira dhe forcimi i kapaciteteve teknike të stafit

Vlerësimi i progresit: 95% i zbatimit të masave

7.2. Sigurimi i Informacionit Bashkëkohor për Bujqësinë

- Gjendja aktuale: Janë organizuar trajnime dhe aktivitete në terren për fermerët.

- Përmirësime: Janë rritur aktivitetet e këshillimit dhe asistencës teknike.
- Sfida: Mungesa e mjeteve të lëvizjes ka ndikuar në shtrirjen e shërbimeve në zonat e largëta.
- **Vlerësimi i progresit: 85% i zbatimit të masave**

7.3. Menaxhimi i Dokumentacionit dhe Arkivimi

- Gjendja aktuale: Dokumentacioni protokollohet dhe ruhet sipas rregullave në fuqi.
- Përmirësime: Janë zbatuar procedura më të standardizuara për administrimin e dokumenteve.
- Sfida: Duhet të rritet digjitalizimi i arkivës për të siguruar akses më të shpejtë dhe siguri më të madhe të informacionit.

Vlerësimi i progresit: 95% i zbatimit të masave

7.4. Menaxhimi Financiar

Gjendja aktuale: Proceset financiare ndjekin rregulloret përkatëse dhe nuk ka pasur shkelje të identifikuara. Përmirësime: Janë respektuar afatet për raportimin financiar dhe auditimet nuk kanë konstatuar parregullsi. Sfida: Rritja e transparencës në publikimin e raporteve financiare për interesin publik.

Vlerësimi i progresit: 95% i zbatimit të masave

7.5 Risqet e Integritetit dhe Vlerësimi i Tyre

Nr.	Fusha	Përshkrimi i Situatës	Risku i Integritetit
1	Menaxhimi financiar Prokurimet	Nuk janë konstatuar probleme me dokumentacionin financiar, buxhetin apo prokurimet.	Pa risk
2	Menaxhimi i burimeve njerëzore	Ka 6 vënde vakante dhe mungon në organigram 1 jurist, 1 specialist IT dhe 1 magazinjer. Mungesa e Setorit të Statistikës dhe FADN në harmoni dhe me strukturën përkatëse në MBZHR.	Risk i mesëm
3	Arkivimi dhe administrimi i dokumenteve	Dokumentacioni është i unifikuar, me protokoll dhe arkivim sipas rregullave	Pa risk
4	Ofrimi i informacionit për bujqësinë	Nevojitet më shumë mbështetje logjistike për specialistët e ekstensionit.	Risk i mesëm

7.6 Masat për Menaxhimin e Risqeve të Integritetit

Nr.	Masa e Marrë	Afati	Përgjegjësi
1	Rekrutimi i stafit të munguar në organigram	2025-2027	Drejtori i AREB Tiranë

	(jurist, IT, dhe magazinë. Krijimi i sektorit të Statistikës dhe FADN)		
2	Përmirësimi i infrastrukturës për specialistët në terren	2025-2027	Drejtoria e AREB Tiranë
3	Rritja e transparencës në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore	2025-2027	Koordinatori i Integritetit në bashkëpunim me Koordinatorit të Informimit.
4	Monitorimi i rregullt i planit të integritetit	Çdo 6 muaj	Koordinatori i Integritetit dhe grupi punës

7.7 Monitorimi i Planit të Integritetit

Aktiviteti	Frekuenca	Përgjegjësi
Mbledhja e të dhënave për zbatimin e planit	Çdo 6 muaj	Koordinatori i Integritetit sëbashku me grupin e punës.
Raportimi i progresit	Vjetor	Drejtori i AREB Tiranë
Publikimi i rezultateve	Çdo vit	MBZHR

8. Konkluzione dhe Rekomandime :

Ky raport monitorimi për vitin 2025 është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit të Plan Integritetit dhe të hartimit të raportit të monitorimit. Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për vitin 2025, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që sektorët kanë raportuar dhe analizës së kryer rezulton se :

- Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Tiranë ka vijuar me zbatimin dhe monitorimin e Planit të Integritetit duke përmbushur të gjitha detyrimet e parashikuara.
- AREB Tiranë është angazhuar që të ndjek zbatimin e këtij plani.
- Sektorët përkatës kanë shënuar përparime kryesore në forcimin e kapaciteteve të stafit si në trajnim dhe kualifikime.
- Gjatë këtij viti u plotësuan vendet vakante Drejtori AREB Tiranë , Përgjegjësjë e Sektorit të Ekstensionit Bujqësor Tiranë .
- Janë monitoruar strukturat vartëse të AREB Tiranë , lidhur me zbatimin e PI.
- Konstatohet se është garantuar nga ana e AREB Tiranë transparenc e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktiviteti e AREB-it për fermerët dhe të tjerë.

9. Hapa të tjerë :

- Të vijohet me zbatimin e rregullt të procedurave të përcaktuara nga dokumentat përkatës të PI dhe të vijohet me ndjekjen e procedurave standarte të veprimit nga strukturat e AREB-it që nuk e disponojnë

veçanërisht për punonjësit e rinj në vitin 2025.

- Të vazhdohet me zbatimin me përpikmëri për evidentimin e risqeve .
- Të vazhdohet me kordinimin dhe bashkëpunimin midis strukturave vartëse të AREB Tiranë, lidhur me zbatimin e PI dhe raportit të monitorimit.
- Sektori i Profilizuar në bashkëpunim me burimet njerëzore të marit masat e nevojshme në lidhje me plotësimin e anketës së integritetit nga punonjësit e rinj si dhe pjesmarja e tyre dhe punonjësve të tjerë në trajnime në vijim nga Koordinatori Integritetit dhe ASPA.
- Njohja në vijim me materialet informuese nga MBZHR dhe institucionet përkatëse.

10.PERFUNDIMI :

Nga monitorimi i deritanishëm rezulton se:

- Institucioni ka bërë përpertime të dukshme në zbatimin e planit të integritetit, sidomos në menaxhimin financiar dhe arkivimin e dokumenteve.
- Vështirësitë kryesore lidhen me mungesën e burimeve njerëzore dhe mjeteve të transportit për ofrimin e shërbimeve në terren.
- Transparenca dhe monitorimi i brendshëm janë përmirësuar, por ka ende hapësirë për përmirësime në rekrutimin dhe digjitalizimin e shërbimeve.
- Sigurimi i mjeteve të transportit: Shtimi i mjeteve të lëvizjes për specialistët e ekstensionit për të mbuluar më mirë zonat rurale.
- Rritja e transparencës: Publikimi i raporteve periodike mbi aktivitetet dhe shpenzimet institucionale.

Përfundim

Zbatimi i Planit të Integritetit në AREB Tiranë ka pasur një ecuri pozitive, me përpertime të dukshme në disa fusha kyçe.

Megjithatë, disa sfida mbeten ende të pazgjidhura dhe kërkojnë përmirësime të mëtejshme për të arritur objektivat e plota të planit në vijim.